

LIGJ
Nr. 108/2014

PËR POLICINË E SHTETIT*

(shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 26.6.2015 dhe ndryshuar me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017, ndryshuar me ligjin nr. 112/2018, 20.12.2018)

(përditësuar 2017)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëni e punës, garantimin e karrierës, mirëqenies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të policisë.

**Neni 2
Misioni i Policisë së Shtetit**
(hequr fjalë me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

Policia e Shtetit ka përmision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritet e njeriut.

**Neni 3
Juridiksioni**

Policia e Shtetit ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4
Statusi i Policisë së Shtetit**

1. Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

* Ligji nr. 108/2014, datë 31.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 1 shtator 2014.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 26.6.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 117, date 8 korrik 2015.

Ligji nr. 58/2017, datë 20.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 10 maj 2017.

Ligji nr. 112/2018, datë 20.12.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 15 janar 2019.

2. Policia e Shtetit është e depolitizuar.

3. Statusi i Policisë së Shtetit nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj, janë:

- a) ligjshmëria;
- b) mosdiskriminimi;
- c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ç) proporcionaliteti;
- d) pavarësia operacionale;
- dh) paanshmëria politike;
- e) integriteti, merita dhe profesionalizmi;
- ë) transparenca;
- f) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
- g) kontrolli dhe llogaridhënia.

Neni 6

Përkufizime

(shfuqizuar pika 15, shtuar pikat 30, 31 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017, ndryshuar pika 16 dhe shtuar pika 32 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emërimi në detyrë” është momenti i fillimit të marrëdhënies së punës për punonjësin e policisë.

2. “Ecuria në karrierë” përfshin të gjitha fazat e karrierës që nga emërimi në detyrë i punonjësit të policisë deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

3. “Gradë policore” është shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues.

4. “Informacioni policor” është tërësia e të dhënave dhe fakteve që sigurohen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe për parandalimin e veprave penale.

5. “Informacion i klasifikuar” është çdo njoħuri që mund të komunikohet apo dokumentohet, pavarësisht nga forma, dhe që është nën kontrollin e strukturave shtetërore dhe është i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. “Impiente stacionare të përgjimit ambiental” janë pajisjet që vendosen në një ambient përgjim, sipas legjislacionit në fuqi.

7. “Këshilli i Politikave” është organ këshillimor për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në ushtrimin e detyrave.

8. “Kontrolli i territorit” është tërësia e veprimeve që ndërmerr policia në një territor të caktuar ose në të gjithë territorin e vendit për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

9. “Lirimi nga policia” është ndërprerja e marrëdhënieve juridike dhe financiare të punonjësit të policisë.

10. "Ministri" është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

11. "Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike" është têrësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i policisë, duke filluar nga forma verbale e bindjes deri në përdorimin e forcës në mënyrë proporcionale për rivendosjen e rendit, në përputhje me legjislacionin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut.

12. "Masa të veçanta" është têrësia e veprimeve të ligjshme për zbulimin ose parandalimin e një veprimtarie kriminale kur ajo nuk mund të zbulohet ose të parandalohet me rrugë e mënyra të tjera.

13. "Nëpunës civil" është personi i emëruar në strukturat e policisë, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen me legjislacionin e nëpunësit civil.

14. "Policia e Shtetit" është institucioni i administratës shtetërore, përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, në vijim policia.

15. Shfuqizuar.

16. "Punonjës policie" është personi i emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit pas përfundimit të arsimit/kualifikimit përkatës dhe mban gradë policore.

17. "Punonjës administrativ" është personi i emëruar në strukturat e Policisë në funksione pa gradë policore, marrëdhëniet e punës të të cilit rregullohen sipas Kodit të Punës.

18. "Përjashtimi nga policia" është ndërprerja e marrëdhënieve juridike të punonjësit të policisë.

19. "Pranimi në polici" është marrja e atributeve të punonjësit të policisë me akt të drejtorit të policisë.

20. "Përdorimi i forcës" është veprimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera apo armëve të zjarrit, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

21. "Përpunimi i të dhënavë personale për qëllime policore" është çdo veprim për përpunimin e të dhënavë personale, i kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale.

22. "Reagimi i menjëhershëm" është një veprim i ligjshëm i ndërmarrë me iniciativë nga punonjësi/ja i/e policisë sapo kupton rrezikun.

23. "Struktura të veçanta" janë strukturat e policisë që veprojnë në një territor të caktuar ose në të gjithë territorin e vendit në varësi të strukturës qendrore apo vendore.

24. "Shkelje disiplinore" është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, objekt i punës së policisë dhe që nuk përbën vepër penale.

25. "Shoqërimi" është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

26. "Transferimi" është kalimi në një detyrë tjeter i punonjësit të policisë.

27. "Varësi lëndore" është varësia që kanë strukturat vendore në raport me strukturën qendrore.

28. "Veprimtari gjurmuese" është veprimtaria e punonjësve të Policisë së Shtetit e kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin, analizimin e të dhënavë dhe informacioneve për veprimtari kriminale.

29. "Veprimtaria hetimore" është veprimtaria që kryhet në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

30. “Vërtetimi i besueshmërisë” është dokument i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i cili pasqyron rezultatet e verifikimit të dhënave të vetëdeklaruara në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që lëshohet nga autoritetet vendore të Policisë së Shtetit, për shtetasin/personin, i cili pranohet apo rikthehet në Policinë e Shtetit.

31. “Policimi vullnetar” është ofrimi vullnetar i shtetasve, në ndihmë të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit, qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile.

32. “Funksione të veçanta” do të konsiderohen ato të cilat nuk ofrohen nga Akademia e Sigurisë.

**KREU II
AUTORITETET**

Neni 7
Ministri

1. Ministri:

a) harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, me qëllim garantimin e rendit e të sigurisë publike;

b) përcakton drejtimet strategjike dhe objektivat e Policisë së Shtetit;

c) kërkon performancë të lartë të Policisë së Shtetit për realizimin e objektivave të përcaktuar;

ç) i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të raportojë për ushtrimin e detyrave të tij dhe të Policisë së Shtetit në përputhje me legjislacionin dhe Kushtetutën duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut;

d) mbikëqyr procesin e ankimeve në Policinë e Shtetit dhe shqyrton ankesat ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

dh) përgatit dhe publikon raportin vjetor për arritjen e objektivave nga Policia e Shtetit.

2. Ministri mbikëqyr menaxhimin e buxhetit të Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit finanziar.

3. Ministri nuk ndërhyr në pavarësinë operacionale të shërbimit të policisë dhe nuk përfshihet në drejtimin operacional të saj.

Neni 8

Marrëdhëni e ministrit me Policinë e Shtetit

Ministri nuk informohet për:

a) veprime hetimore, akte apo të dhënat e përftuara prej tyre;

b) informacione që kanë të bëjnë me identitetin, procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose vendndodhjen e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose informatorëve;

c) të dhëna dhe informacione të përftuara nga personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ e operacional i policisë dhe përgjigjet drejtpërdrejt para ministrit për realizimin e politikave, performancës dhe objektivave të përcaktuar.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit:

- a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë;
- b) menaxhon burimet njerëzore;
- c) menaxhon dhe është përgjegjës për buxhetin;
- ç) nxjerr akte administrative të përcaktuara në Rregulloren e Policisë;
- d) përfaqëson policinë në marrëdhëniet me institucionet e tjera brenda vendit, si dhe në marrëdhëni tekniqe dy ose shumëpalëshe me jashtë.

Neni 10

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, mbështetet nga një zëvendësdrejtor.
2. Zëvendësdrejtori kryen detyrat që i caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
3. Ministri cakton zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e drejtorit në rastet kur:
 - a) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk është emëruar ende;
 - b) në rast paaftësie ose pezullimi nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk mund të ushtrojë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë, më shumë se 6 muaj.

Neni 10/1

Drejtori i departamentit

(shtuar me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Drejtori i departamentit është autoritet i lartë, që drejton një departament, i cili është strukturë organizative në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Drejtori i departamentit përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për veprimtarinë e departamentit që drejton.
3. Përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë e drejtorit të departamentit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
4. Numri i drejtorive të departamentit përcaktohet në varësi të strukturës organizative të Policisë së Shtetit, e cila miratohet nga ministri.
5. Emërimi, kriteret e emërimit, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të departamentit janë të njëjtë me ato të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
6. Drejtori i departamentit qëndron në detyrë për një periudhë prej 4 vjetësh, me të drejtë riemërimi edhe për 4 vjet të tjera.

Neni 11

Emërimi, kriteret e emërimit dhe detyrat e drejtorit të drejtorisë vendore të policisë

1. Drejtori i drejtorisë vendore emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, bazuar në standardin e gradave, dhe nëse plotëson njëkohësisht kriteret si vijon:
 - a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
 - b) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale;

- c) të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- ç) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 viteve të fundit;
- d) të mos ketë konflikt interes i ushtrimin e detyrës.

2. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ e operacional i policisë vendore dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për rendin e sigurinë publike në juridikcionin e drejtorisë vendore.

3. Drejtori i drejtorisë vendore:

- a) drejton dhe koordinon veprimitarinë e strukturave;
- b) menaxhon burimet njerëzore;
- c) menaxhon buxhetin;
- ç) nxjerr akte të përcaktuara në Rregulloren e Policisë;

d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore brenda juridikzionit dhe fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.

Neni 12
Shefi i komisariatit

1. Shefi i komisariatit të policisë emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përputhjet me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

2. Shefi i komisariatit të policisë është drejtues i nivelit operacional në territorin që mbulon dhe përgjigjet para drejtorit të policisë vendore për rendin e sigurinë publike në juridikcionin e komisariatit të policisë.

3. Shefi i komisariatit të policisë:

- a) drejton veprimitarinë e strukturave;
- b) menaxhon burimet njerëzore;
- c) menaxhon buxhetin;
- ç) nxjerr akte të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore brenda juridikzionit dhe fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.

KREU III
EMËRIMI, LIRIMI/SHKARKIMI NGA DETYRA I AUTORITETEVE POLICORE

Neni 13

Kriteret e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

(ndryshuar pikat 1 dhe 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Këshilli i Ministrave emëron Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me propozim të ministrit përgjegjës, një nga punonjësit e policisë që mban gradën “Drejtues i lartë” ose “Drejtues i parë” dhe i jep gradën “Drejtues madhor”.

2. Përveç kriterit të gradës, kandidati i propozuar për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duhet të plotësojë kriteret si vijon:

- a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë të paktën 15 vjet përvojë në polici, nga të cilat të paktën 10 vjet në pozita të larta drejtuese në strukturat e Policisë së Shtetit;
- c) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale;
- ç) të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- d) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 viteve të fundit;
- dh) të mos ketë konflikt interes i ushtrimin e detyrës;

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 vjetësh me të drejtë riemërimi edhe për 5 vjet të tjera.

Neni 14

Emërimi dhe kriteret e emërimit të Zëvendësdrejtorit i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
(ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Ministri emëron Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, një nga punonjësit e policisë që mban gradën “Drejtues i parë” dhe njëkohësisht plotëson kriteret si vijon:

- a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë të paktën 12 vjet përvojë në polici, nga të cilat të paktën 8 vjet në pozita të larta drejtuese në strukturat e Policisë së Shtetit;
- c) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale;
- ç) të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- d) të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 viteve të fundit;
- dh) të mos ketë konflikt interesit në ushtrimin e detyrës;

2. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit qëndron në detyrë për një periudhë prej 4 vjetësh, me të drejtë riemërimi edhe për 4 vjet të tjera.

Neni 15

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit lirohet nga detyra kur:

- a) humbet shtetësinë shqiptare;
- b) i përfundon afati i qëndrimit në detyrë dhe nuk riemërohet;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 muaj;
- d) plotëson moshën për pension;
- dh) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit shkarkohet nga detyra kur:

- a) dënohet me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
- b) nuk përmbushen objektivat strategjikë për shkak të performancës së ulët të tij.

3. Lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, pas përfundimit të afatit të qëndrimit në detyrë, nuk rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit. Në interes të shërbimit të rendit dhe sigurisë publike ai mund të kryejë funksione të tjera këshillimore ose pedagogjike. Pas përfundimit të mandatit, ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit gëzon trajtim të veçantë, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Lirimi apo shkarkimi nga detyra i Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
(shtuar shkronja a/1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit lirohet nga detyra kur:

- a) i përfundon afati i qëndrimit në detyrë dhe nuk riemërohet;
- a/1) humbet shtetësinë shqiptare;

b) jep dorëheqjen;
c) është i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 muaj;

c) plotëson moshën për pension.

2. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit shkarkohet nga detyra kur:

- a) dënohet me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen një vepre penale;
- b) për shkak të performancës së ulët të tij nuk përmblushen objektivat.

3. Lirim i shkarkimit i Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit bëhet me urdhër të ministrit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

KREU IV DETYSRAT E POLICISË SË SHTETIT

Neni 17

Detyrat

(*shfuqizuar shkronja "h" me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017*)

1. Detyrat e Policisë së Shtetit janë:

- a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private;
- b) ruan rendin dhe sigurinë publike;
- c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;

ç) organizon fushata ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun;

d) koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional;

dh) identifikon, siguron dhe trajton në ambientet e saj, personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masë s së sigurimit me vendim gjykate, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

e) mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor;

ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë;

f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

g) identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë;

gj) administrojn dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion;

h) Shfuqizuar.

i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2. Punonjësve të strukturave të tjera të zbatimit të ligjit u kërkohet të vihen në shërbim të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të atributave në funksion të detyrave institucionale të njohura nga ligji.

Neni 18
Atributet e Policisë Gjyqësore

Çdo punonjës i policisë gjëzon atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjisacionin procedural penal dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

KREU V
ORGANIZIMI I POLICISË SË SHTETIT

Neni 19
Organizimi dhe struktura e përgjithshme e Policisë së Shtetit
(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Ajo organizohet mbi bazë shërbimi, e profilizuar në Policinë Kriminale, Policinë për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin dhe Migracionin. Kategoritë e profilizuara të Policisë së Shtetit dallojnë midis tyre nga arsimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përfaqëson nivelin qendror dhe drejtoritë vendore nivelin vendor të policisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel departamenti, drejtorie dhe sektori.

4. Drejtoria vendore organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel drejtorie, sektori, komisariati, seksioni, stacioni dhe poste policie.

5. Në varësi të Drejtitorit të Policisë së Shtetit bëjnë pjesë edhe struktura të veçanta, që ushtrojnë veprimtarinë në gjithë territorin ose në pjesë të veçanta të tij.

6. Numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

7. Struktura dhe organika e policisë në nivel qendror miratohen nga ministri, me propozimin e Drejtitorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

8. Struktura dhe organika e policisë në nivel vendor dhe i strukturave të veçanta miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 20
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është struktura qendrore administrative dhe teknike e policisë, me seli në Tiranë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përbëhet nga struktura, sipas fushave dhe shërbimeve përkatëse.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kryen këto detyra:

a) menaxhon veprimtarinë e Policisë;

b) bashkërendon veprimtarinë mes strukturave për:

i) hartimin dhe zbatimin e strategjive për realizimin e përgjegjësive të Policisë së Shtetit;

ii) hartimin dhe zbatimin e planeve për rekrutimin, arsimimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë;

iii) vënien në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që lidhen me Policinë;

c) planifikon, drejton operacione dhe hetime në shkallë vendi;

- c) realizon koordinimin dhe drejtimin strategjik në raste të emergjencave, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare;
- d) kryen kërkime shkencore dhe teknologjike në fushën e sigurisë;
- dh) përgatit studime, harton në mënyrë periodike analiza risku dhe analiza të tjera për realizimin e misionit të policisë;
- e) informon publikun në lidhjen me zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;
- ë) bashkëpunon me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe struktura shtetërore për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe sigurinë kombëtare;
- f) bashkëpunon me strukturat kombëtare, ndërkombëtare, si dhe organizatat joftimprurëse që kanë për mision monitorimin e standardeve të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut;
- g) përponon dhe analizon të dhënat e mbledhura nga Policia deri në masën që është e nevojshme për përbushjen e detyrave e të funksioneve të sa;
- gj) planifikon e menaxhon buxhetin dhe burimet e tjera financiare, infrastrukturën dhe bazën materiale teknike të Policisë Shtetit që ka në administrim;
- h) njofton Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për llojin e të dhënave që krijon dhe administron policia, për qëllimin e këtij ligji;
- i) kryen detyra policore, në përputhje me këtë ligj, ligje të tjera dhe akte të dala në zbatim të tyre.

**Neni 21
Struktura e kufirit dhe migracionit**

1. Në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislativin në fuqi.

2. Struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit organizohet në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal.

Ruajtja dhe mbrojtja e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë
(shfuqizuar me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

**Neni 23
Drejtoria vendore e policisë**

1. Drejtoria vendore e policisë është strukturë administrative e policisë në nivel vendor.
2. Drejtoria vendore e policisë kryen veprimtari operacionale dhe hetimore në nivel vendor, mbikëqyr dhe kontrollon kryerjen e detyrave, si dhe bashkërendon veprimtarinë e strukturave në varësi.

**Neni 24
Komisariati dhe stacioni i policisë**

1. Komisariati i policisë është strukturë bazë operacionale në varësi të drejtorisë vendore

të policisë dhe ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridikcion.

2. Stacioni i policisë është njësi policore operacionale në varësi të komisariatit ose, në raste të veçanta, kur nuk ka komisariat, në varësi të drejtorisë vendore të policisë.

Neni 25

Vlerësimi i performancës së strukturave të policisë

1. Vlerësimi i performancës së strukturave të Policisë së Shtetit bëhet nga struktura e posaçme në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Procedurat dhe mënyrat e vlerësimit të performancës përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 26

Këshilli i Politikave

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit funksionon Këshilli i Politikave, i cili i jep orientime dhe rekomandime drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të trajtuar çështje që kanë të bëjnë me politikat dhe strategjitet e policisë.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të grupit të politikave përcaktohet me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm Policisë së Shtetit.

KREU VI

BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

(*shfuqizuar kreu me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 26.6.2015*)

KREU VII

PRANIMI, FORMIMI DHE ECURIA NË KARRIERË

Neni 37

Akademia e Sigurisë

(*ndryshuar dhe shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017, shtuar pika 3 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018*)

1. Policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial.

2. Akademia e Sigurisë ofron formim, specializime dhe kualifikime për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, si dhe për persona fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike.

3. Për nevoja të Policisë së Shtetit, pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 38. Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore “Nënkomisar”.

3. Akademia e Sigurisë njeh dhe ekuivalenton diplomat, dëshmitë dhe certifikatat e përfshira në institucionet brenda dhe jashtë vendit në fushën e rendit e të sigurisë, në bazë të marrëveshjeve dhe që nuk mund të njësohen, sipas pikës 4, të këtij neni.

4. Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave për shtetasit që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit në fushën e rendit dhe sigurisë publike bëhen sipas legjislacionit për arsimin e lartë.

5. Organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Sigurisë përcaktohen me vendim të

Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë

(shtuar shkronja "f" në pikën 2 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017,
ndryshuar shkronja "b" dhe shtuar shkronja "g" të pikës 2, me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Pranimi në Akademinë e Sigurisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur.
2. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil.
 - c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
 - d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
 - dh) të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
 - e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B;
 - f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.
 - g) të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurrimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm.
3. Shfuqizuar.

Neni 39

Statusi i punonjësve të policisë

Punonjësi i policisë është nëpunës civil, ndaj të cilit zbatohen dispozitat e ligjit për nëpunësin civil, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Neni 40

Pranimi në funksione të veçanta

(hequr një fjali në pikën 2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017; ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Për funksione të veçanta në polici, ku kërkohen njohuri specifike, të cilat nuk përfitojnë në Akademinë e Sigurisë, pranohen nëpërmjet konkurrimit, shtetas që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të mos jetë i përjashtuar nga policia ose të jetë larguar nga shërbimi civil;
 - c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
 - d) të ketë përfunduar arsimin e lartë përkatës;
 - dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën përkatëse;
 - e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - ë) të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B.
2. Personi që shpallet fitues pranohet në këto funksione pas përfundimit të kualifikimit në

Akademinë e Sigurisë dhe i jepet grada që i korrespondon funksionit ku do të emërohet.

3. Personi i pranuar në funksione të veçanta nuk ka të drejtë të aplikojë për ngritje në gradë/detyrë apo të transferohet në funksione të tjera policore për një periudhë 6-vjeçare.

4. Numri i personave të pranuar, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 3 për qind e limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit.

5. Procedurat, rregullat e konkurrimit, transferimit brenda funksioneve të veçanta, si dhe funksionet e veçanta përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 40/1

(shtuar me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Për plotësimin e nevojave të veçanta, mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 38, të këtij ligji.

2. Për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtaraku dhe mbi bazë marrëveshjeje dypalëshe, ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat, struktura dhe funksionet e veçanta nga ku do të pranohen.

3. Në çdo rast, pranimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet pas nxjerrjes në lirim nga Forcat e Armatosura të ushtarakëve, nga autoritetet kompetente të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Pranimi realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

5. Kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura te Policia e Shtetit realizohet duke njojur e ruajtur vjetërsinë e shërbimit.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, miraton ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit.

Neni 41

Pranimi në funksione ndihmëse të policisë

1. Pranimi në funksione ndihmëse të nëpunësve civilë bëhet bazuar në legjislacionin për nëpunësin civil.

2. Pranimi dhe largimi në/nga funksione ndihmëse për punonjësit administrativë bëhet me urdhër të titullarit të strukturës qendrore ose vendore, sipas Kodit të Punës dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

3. Punonjësit që pranohen në funksionet ndihmëse trajnohen në Akademinë e Sigurisë gjatë periudhës së provës.

Neni 42

Baza e të dhënave të shenjave të gishtave dhe ADN-së së punonjësve të policisë

1. Punonjësit të policisë i merren shenjat e gishtave, mostra e ADN-së dhe ato të balistikës së armës personale, duke u dokumentuar veprimi në praninë e tij dhe ruhen në bazën e të dhënave të policisë.

2. Shenjat e gishtave, mostra e ADN-së dhe ato të balistikës së armës personale, të administruara në bazën e të dhënave, asgjësohen kur punonjësi i policisë ndërpërt marrëdhëni e punës.

3. Rregullat dhe procedurat e marrjes, administrimit dhe asgjësimit të këtyre të dhënave përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 43

Transferimi i punonjësit të policisë

(ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Punonjësi i policisë transferohet nga një detyrë në një tjetër brenda së njëjtës gradë që mban, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

2. Punonjësi i policisë, gjatë periudhës 1-vjeçare të provës, nuk transferohet, me përjashtim të rasteve të veçanta të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Drejtorët e drejtorive vendore të policisë apo titullarët e strukturave të veçanta transferojnë punonjës policie të rolit zbatues në funksione, të cilat janë brenda juridiksionit të tyre, me kusht që funksioni të mos ketë gradë më të ulët se ajo që mban punonjësi.

4. Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Punonjësi i policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

6. Në çdo rast, transferimi i punonjësit të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të motivuar dhe i komunikohet personit të transferuar.

7. Rregullat dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 44

Transferimi i punonjësit të funksioneve ndihmëse

Transferimi i nëpunësit civil bëhet bazuar në legjislacionin për nëpunësin civil.

Neni 45

Transferimi i përkohshëm i punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë transferohet përkohësisht në një detyrë tjetër:

- për zëvendësimin e një punonjësi/e të policisë;
- kur funksioni organik është i paplotësuar;
- për përballimin e dinamikës së punës si rezultat i situatave të paparashikuara.

2. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

3. Rregullat dhe procedurat e transferimit të përkohshëm përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

4. Transferimi i përkohshëm për punonjësit me status të nëpunësit civil bëhet sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil.

Neni 46

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë

1. Punonjësi i policisë ndërpert marrëdhënet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga policia.

2. Punonjësi i policisë lirohet nga policia në rastet kur:

- mbush moshën për pension pleqërie;

- b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;
- c) kërkon vetë të lirohet;
- c) shkurtohet funksioni në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë;
- d) konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit;
- dh) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së tij;
- e) humbet shtetësinë shqiptare;
- ë) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

3. Punonjësit të policisë, të cilil i shkurtohet funksioni organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë dhe nuk ka vend të lirë për gradën që mban, sipas shkronjës “ç”, të pikës 2, të këtij nenit, i ofrohet një funksion i një nivelit më të ulët, duke ruajtur gradën për një periudhë deri në një vit. Pas kalimit të këtij afati, në pamundësi sistemimi për gradën që ka, punonjësi lirohet nga policia.

4. Punonjësi i policisë përjashtohet nga policia në këto raste:

- a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- b) kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga policia.

5. Punonjësi i policisë, i cili ndërpërt marrëdhëniet e punës në rastet e pikës 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “ë”, dhe të pikës 4, shkronja “b”, ka të drejtë të ankohet në komisionin e apelimit ose drejtpërdrejt në gjykatë.

6. Rregullat dhe procedurat e ndërpërjes së marrëdhënieve të punës përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 47

Ndërpërja e marrëdhënieve të punës të nepunësit dhe punonjësit civil

1. Nëpunësi civil ndërpërt marrëdhëniet e punës në rastet e parashikuara në ligjin për nepunësit civilë.

2. Punonjësi civil ndërpërt marrëdhëniet e punës sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.

Neni 48

Vlerësimi i punonjësve

1. Punonjësi i policisë vlerësohet individualisht për treguesit e punës nga eprori i drejtpërdrejtë i tij.

2. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit individual përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 49

Rikthimi në Polici

1. Një person mund të rikthehet në polici vetëm nëse ai ka ndërpërë marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit brenda 2 viteve të fundit dhe është liruar nga Policia për shkurtim të funksionit, në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë.

2. Personi, që trajtohet me pension të parakohshëm suplementar ose pension të shërbimit, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij nenit, nuk rikthehet në polici.

3. Procedurat për rikthim në polici përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

KREU VIII
GRADAT

Neni 50
Sistemi i gradave

1. Sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit në Policinë e Shtetit.
2. Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit.

Neni 50/1
Hierarkia e menaxhimit policor
(*shtuar me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017*)

Gradat në polici ndahen në role, sipas kompetencës së veprimit dhe nivelit të menaxhimit, si më poshtë:

- a) në rolin zbatues, ku përfshihen punonjësit e polisë që mbajnë gradën “Inspektor”, “Inspektor i dytë”, dhe “Inspektor i parë”, që përfaqësojnë nivelin bazë të veprimit policor;
- b) në rolin e parë drejtues, ku përfshihen punonjësit e polisë që mbajnë gradën “Nënkomisar”, “Komisar” dhe “Kryekomisar”, që përfaqësojnë nivelin taktik të drejtimit dhe veprimin teknik operacional;
- c) në rolin e mesëm drejtues, ku përfshihen punonjësit e polisë që mbajnë gradën “Drejtues” dhe “Drejtues i parë”, që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit ekzekutiv qendror dhe/ose vendor;
- ç) në rolin madhor, ku përfshihen punonjësit e polisë që mbajnë gradën “Drejtues i lartë” dhe “Drejtues madhor”, që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit strategjik.

Neni 51
Gradat
(*shtuar shkronjat a/1 dhe a/2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017*)

1. Gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen, si më poshtë:

- a) Inspektor;
- a/1) Inspektor i dytë;
- a/2) Inspektor i parë;
- b) Nënkomisar;
- c) Komisar;
- ç) Kryekomisar;
- d) Drejtues;
- dh) Drejtues i parë;
- e) Drejtues i lartë;
- ë) Drejtues madhor.

2. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të polisë në karrierë janë komisionet e vlerësimit. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohet në Rregulloren e Policisë.

Neni 52
Hierarkia e gradave

Hierarkia e punonjësve të policisë përcaktohet nga grada, nga funksioni për punonjësit me të njëjtën gradë dhe nga vjetërsia në gradë për punonjësit me gradë e funksion të njëjtë.

Neni 53
Marrja e gradës

(ndryshuar titulli, shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Grada “Inspektor” u jepet punonjësve të policisë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit kur përfundon arsimin policor.

1/1. Gradat “Inspektor i dytë” dhe “Inspektor i parë”, për punonjësit e policisë që plotësojnë afatin e qëndrimit në gradë, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, jepen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit mbi bazën e vjetërsisë në punë, trajnimeve dhe kualifikimeve.

2. Grada “Nënkomisar” deri “Drejtues i parë” jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji.

3. Grada “Drejtues i lartë” jepet nga Ministri.

4. Grada “Drejtues madhor” jepet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Punonjësi i policisë që mban gradën “Drejtues i lartë”, pas përfundimit të afatit të qëndrimit në detyrë, merr gradën “Drejtues i parë”.

Neni 54
Fitimi i gradës

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimim/trajnimit.

2. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive.

3. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse.

4. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë që plotësojnë kriteret e vendosura në këtë ligj.

Neni 55
Kriteret për fitimin e gradës

(shfuqizuar shkronjat “ç” e “d” dhe ndryshuar shkronja “i” me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017; ndryshuar shkronja “b” e pikës 1 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Për fitimin e gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” punonjësi i policisë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 për qind të vlerësimit të përgjithshëm;

b) të përbushë kriteret për pozicionin e punës dhe të ketë përfunduar arsimin e lartë.

- c) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj;
- c) shfuqizuar;
 - d) shfuqizuar;
- dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- e) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
- ë) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:
- | | |
|--|------------|
| i) nga "Inspektor" deri në "Inspektor i dytë", | 5 vjet; |
| i/1) nga "Inspektor i dytë" deri në "Inspektor i Parë", | 10 vjet;". |
| i/2) punonjësit të policisë në rolin zbatues, që ka vjetërsi shërbimi mbi 5 vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës "Nënkomisar"; | |
| ii) nga "Nënkomisar" në "Komisar" | 3 vite; |
| iii) nga "Komisar" në "Kryekomisar" | 3 vite; |
| iv) nga "Kryekomisar" në "Drejtues" | 5 vite; |
| v) nga "Drejtues" në "Drejtues i parë" | 3 vite; |
| vi) nga "Drejtues i parë" në "Drejtues i lartë" | |
- ose "Drejtues madhor" 2 vite.

2. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:

- a) paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj brenda afatit 12-mujor;
- b) vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
- c) lejes së lindjes.

3. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë pagese.

Neni 56

Verifikimi i kandidatëve

1. Punonjësi i policisë, që aplikon për fitimin e gradës, i nënshtrohet procesit të verifikimit nga struktura qendrore e burimeve njerëzore.

2. Verifikimi i kandidatit përfshin plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 55, të këtij ligji, gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit deri në momentin e fitimit të gradës.

Neni 57

Fazat e testimit të kandidatëve

(ndryshuar fjalë në pikën 2, ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Për fitimin e gradës "Nënkomisar" deri në "Komisar", kandidati vlerësohet në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë.

2. Për fitimin e gradës "Kryekomisar" deri në "Drejtues i parë", kandidati vlerësohet në testimin me shkrim, ushtrime vlerësuese dhe intervistë.

3. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.

4. Përbërja e komisioneve të vlerësimit dhe ankimit, rregullat dhe procedurat e zhvillimit dhe vlerësimit të kandidatëve në fazat e testimit përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 58

Shpallja e fituesve për procesin e gradimit

(ndryshuar titulli dhe hequr fjalë me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

Numri i personave të shpallur fitues nuk mund të jetë më shumë se 30 për qind mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

Neni 59

Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës

(ndryshuar pika 3 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Punonjësi i policisë i shpallur fitues për gradën “Nënkomisar” dhe “Drejtues” duhet të përfundojë programin e arsimimit përkatës, ndërsa për fitimin e gradave të tjera duhet të përfundojë programin e trajnimit përkatës menjëherë pas miratimit të listës emërore të së drejtës për gradë.

2. Punonjësi i policisë zgjidhet për të ndjekur programin e arsimimit /trajnimit, duke u bazuar në listën emërore të së drejtës për gradë.

3. Pas përfundimit të programit të arsimimit/trajnimit, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit dhe arsimimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi i cili ka vlerësimin më të lartë.

4. Shfuqizuar.

Neni 59/1

Dhënia e gradës

(shfuqizuar me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

Në përfundim të procesit të testimit dhe të arsimimit/kualifikimit, dhënia e gradës bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.

Neni 60

Procesi i ankimit

1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit në komisionin e apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin në gradë. Ushtrimi i së drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e Policisë pezullon nxjerrjen e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të vlerësimit që është ankimuar.

2. Komisioni i apelimit kryesohet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit dhe afatet e ankimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

3. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të policisë duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

4. Vendimi i komisionit të apelimit është i zbatueshëm menjëherë.

5. Procedurat për fitimin e gradës nga momenti i shpalljes së procesit të konkurrimit deri në përfundim të procesit të ankimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 61
Përcaktimi i funksioneve për gradë

1. Tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimi i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese.

Neni 62
Paraqitja e gradave

Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IX
MARRËDHËNIA E PUNËS DHE TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 63
Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit e policisë njësohet me atë të punonjësve të tjera të administratës shtetërore.
2. Punonjësi i policisë gjëzon të drejtën e pushimit vjetor, si dhe të pushimeve të tjera të pagueshme.
3. Pushimi vjetor për punonjësin e funksioneve ndihmëse njësohet me atë të administratës shtetërore, ndërsa për punonjësit e policisë është 28 deri në 40 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas vjetërsisë dhe gradave.
4. Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi në vlerë financiare.
5. Punonjësi i policisë trajtohet me pushim ose pagë shtesë për mbi kohën normale të punës.
6. Rregullat dhe procedurat e përfitimit të pushimeve dhe trajtimit finansiar të punonjësit të policisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 64
Kujdesi për gratë shtatzëna

1. Punonjëset e policisë shtatzëna ose më fëmijë në gji nuk mund të punësohen në punë ose shërbime që mund të dëmtojnë shëndetit e tyre dhe të fëmijës.
2. Nuk lejohet puna e natës për punonjëset e policisë shtatzëna.
3. Këshilli i Ministrave cakton sektorët e shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës, rregullat e veçanta për kushtet e punës për punonjëset e policisë që janë shtatzëna, si dhe rastet kur lejohet puna e natës për punonjëset e policisë dhe nënët me fëmijë në gji.

Neni 65
Leja e lindjes

1. Punonjëset e policisë shtatzëna gjëzojnë të drejtën e lejes së paralindjes dhe paslindjes,

sipas legjislacionit në fuqi.

2. Të ardhurat që përfitohen në rast leje lindjeje, përcaktohen nga ligji për sigurimet shoqërore.

Neni 66
Leja pa të drejtë page

1. Punonjësi i policisë gjëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 muaj ose afatgjatë deri në 3 vjet.

2. Leja afatshkurtër miratohet nga drejtuesi i strukturës dhe pas përfundimit të lejes punonjësi kthehet në të njëjtën detyrë.

3. Leja afatgjatë jepet për studime ose kualifikime dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

4. Pas përfundimit të lejes afatgjatë, punonjësi ka të drejtë të kthehet në funksionin që kishte ose në funksion tjetër në raport me graden që mban.

5. Rregullat dhe procedurat e lejes pa të drejtë page përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 67
Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë
(shtuar shkronja "d" në pikën 2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Punonjësi i policisë, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ka përparësi në trajtimin financiar, ku përfshihen:

a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesë për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune;

b) kompensimi për privacionet që i krijohen punonjësit të policisë për largësi nga vendbanimi, sipas kostos së transportit publik dhe paga për papunësinë e bashkëshortit/es;

c) trajtimi me ushqim për punonjësit e policisë;

c) ndihma financiare në masën e një page mujore në rastet e fatkeqësive në familje;

d) shpërblimi nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në masën e 6 pagave mujore, për rezultate të larta në kryerjen e detyrës. Kriteret e përfitimit të shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit. Shpërblimi përballohet nga fondi i pagave;

dh) ndihma e menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.

2. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të policisë, sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç", "d" e "dh" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 68
E drejta për sigurim shëndetësor të veçantë

1. Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, në funksion të përbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Sigurimi i shëndetit për punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara

në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon shpenzimet për kontrollin parandales, diagnostikues dhe kurues, të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.

3. Lista e shërbimeve shëndetësore, si dhe autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore, rast pas rasti, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë, sipas këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 69

E drejta për përfitim kredie me interesa të butë

1. Punonjësi i policisë përfiton kredi për strehim me një interes në masën 3 për qind.

2. Rimbursimi i interesave të kredisë ndërpritet për punonjësin e policisë vetëm në rastin kur ai/ajo përjashtohet nga policia.

3. Kriteret për përfitimini e kredisë për strehim dhe masa e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 70

Kompensimi për strehim

1. Kur punonjësi i policisë emërohet/transferohet jashtë vendbanimit të tij të pérhershëm, brenda dhe jashtë vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo.

2. Kriteret dhe masa e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 71

Sigurimi i jetës

Punonjësi i policisë përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 72

Mbrojtja e veçantë

1. Policia siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e policisë, të cilit i kërcenohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.

2. Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësin e policisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

1. Punonjësi i policisë, që ndërpërt marrëdhëni e punës me Policinë e Shtetit, përfiton:

- a) pagesë kalimtare;
- b) pension të parakohshëm suplementar;
- c) pension shërbimi;
- ç) pension suplementar pleqërie.

2. Trajtimi financiar për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me ligj të veçantë.

Neni 74

**Vjetërsia për trajtim finançiar pas ndërprerjes
së marrëdhënieve të punës**

1. Për përfitimin e pagesës kalimtare njihet vjetërsia që ka punonjësi në strukturat e Policisë së Shtetit me status policor.

2. Punonjësit, për përfitimin e pensionit të parakohshëm suplementar, pensionit të shërbimit, si dhe të shtesës së pensionit të pleqërisë i njihet:

- a) vjetërsia në strukturat e Policisë së Shtetit;
- b) vjetërsia në shërbimin ushtarak;
- c) vjetërsia në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- ç) vjetërsia në strukturat e Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Shërbimit Informativ të Shtetit, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- d) vjetërsia në strukturat e Policisë së Burgjeve dhe Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
- dh) koha e studimit në shkollat e larta ushtarake të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Policisë së Shtetit, brenda apo jashtë vendit;
- e) koha e njohur si vjetërsi shërbimi me vendim gjyqësor.

Neni 75

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

1. Kur punonjësi i polisë humb jetën për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:

- a) ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit;
- b) pension familjar suplementar, në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Përfitimet jepen në vlerën 100 për qind të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon;
- c) rimbursim, në masën 100 për qind të bursës së studimit në institucionet e arsimit shtetëror përfundim; përfundim;
- ç) banesë falas për bashkëshorten/in dhe fëmijët kur janë të pastrehë, sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;
- d) ndihmë financiare, në masën e 1 page mujore, sipas pagës referuese, çdo përvjetor vdekje;
- dh) ceremonia mortore organizohet nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhën nga buxheti i polisë;
- e) punësim me prioritet në përpunim me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme përvjetor vdekje;

2. Rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X
BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN DHE SUBJEKTE TË TJERA

Neni 76

Bashkëpunimi me komunitetin
(shtuar pika 3 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Policia bashkëpunon me komunitetin për garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të të drejtave të personave, për rreziqet që mund t'u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale.

2. Policia kërkon ndihmën e publikut për t'u informuar për çështje që lidhen me rendin dhe sigurinë publike, duke ofruar shpërblime e duke garantuar konfidencialitetin e burimit të të dhënave. Kur, për këtë shkak, personave u rrezikohet jeta, familja ose prona, policia u siguron atyre mbrojtje të vecantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me komunitetin, organizon policimin vullnetar. Organizimi, funksionimi dhe fusha e veprimit të policimit vullnetar rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 77

Informimi i publikut

1. Policia informon publikun dhe median për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Policisë i ndalohet që në njoftimet publike të komunikojë në mënyrë joetike, të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjitetin e personit të dyshuar, të viktimave dhe të të miturve.

Neni 78

Bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore dhe njësítë e qeverisjes vendore

1. Në përbushjen e përgjegjësive të saj, policia bashkëpunon me institucionet e administratës shtetërore, me personat fizikë e juridikë.

2. Strukturat vendore të policisë bashkëpunojnë me njësítë e qeverisjes vendore për parandalimin e krimit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, duke respektuar pavarsinë e tyre.

Neni 79

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

1. Policia bashkëpunon me organizatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, bashkësítë fetare të njoitura me ligj, organizatat jofitimprurëse dhe shoqatat, me qëllim krijimin e partneritetit për rendin dhe sigurinë.

2. Policia u siguron atyre informacionin e nevojshëm lidhur me respektimin e të drejtave për personat e shoqëruar në mjediset e policisë mbi bazën e dokumenteve zyrtare të disponuara.

Neni 80

Policimi në komunitet

1. Në nivel vendor policia harton strategji vjetore për policimin në komunitet.

2. Strategjiteti hartohen në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, shoqërinë civile, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe në konsultim me komunitetin.

3. Strategjitet e policimit në komunitet hartohen sipas procedurave të përcaktuara në

Rregulloren e Policisë.

4. Struktura të posaçme të policisë në kuadrin e parandalimit të veprave penale zbatojnë strategjitet e policimit në komunitet.

Neni 81

Bashkëpunimi me të tretët

1. Policia ofron shërbime shtesë sipas mundësive që ka dhe kundrejt pagesës për persona juridikë e fizikë, publikë ose privatë, mbi bazën e kërkesës së tyre.

2. Llojet e shërbimeve dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 82

Bashkëpunimi me shërbimin e sigurisë private

Në rastet e emergjencave ose të fatkeqësive natyrore, Policia kërkon që punonjësit e shërbimeve të sigurisë private të bashkëpunojnë me strukturat e Policisë.

Neni 83

Marrëdhëni me sindikatat e policisë

1. Në polici lejohen krijimi dhe zhvillimi i veprimtarive sindikaliste në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e interesave të punonjësit të policisë.

2. Çdo punonjës i policisë, me përjashtim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ka të drejtë të jetë anëtar i njërsës prej sindikatave.

3. Punonjësit të policisë gjatë veprimtarive sindikaliste i ndalohet të mbajë uniformën e policisë, armën apo të përdorë mjetet ose simbolet e policisë.

4. Marrëdhëni ndërmjet sindikatave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit irregullohen në kontratën kolektive.

Neni 84

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Policia bashkëpunon me polici të shteteve të tjera ose me organizata ndërkombëtare poliore, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dy ose shumëpalaëshe.

KREU XI

DETÝRIMET DHE KUFIZIMET KRYESORE TË PUNONJËSIT TË POLICISË

Neni 85

Detyrimi për respektimin e ligjit dhe formimin profesional

1. Punonjësi i policisë detyrohet të respektojë Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe të mbrojë të drejtat e liritë e njeriut.

2. Punonjësi i policisë mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Punonjësi i policisë kryen me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin detyrat e tij.

4. Punonjësi i policisë ka detyrimin të përmirësojë aftësitë profesionale dhe fizike, nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve.

5. Kriteret e vlerësimit vjetor për aftësitë profesionale, performancën dhe aftësitë fizike

përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 86
Detyrimi për të zbatuar urdhrin

1. Punonjësi i policisë ka detyrimin të zbatojë të gjithë urdhrat e ligjshëm që jepen nga një punonjës më i lartë në funksion ose në gradë.

2. Punonjësi i policisë, nëse ka arsyë të dyshojë se urdhri i dhënë është i paligjshëm, ai menjëherë ia bën të ditur eprorit dhe, kur është e mundur, kërkon me shkrim që urdhri të jepet me shkrim. Në çdo rast, kur ka kërkesë verbale apo me shkresë për dhënien e urdhrit me shkrim, eprori është i detyruar të procedojë sipas kërkesës me shkrim.

3. Në rastet kur moszbatimi i urdhrit deri në dhënien e tij me shkrim, sipas pikës 2, të këtij neni, rrezikon jetën e një personi tjeter, punonjësi i policisë duhet të zbatojë urdhrin.

4. Kur një punonjës policie, edhe pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë nen, vazhdon të ketë arsyë për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai kryen veprimet e mëposhtme:

a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 3, të këtij neni;

b) vë menjëherë në dijeni punonjësin e policisë, i cili është drejtpërdrejt në një funksion më të lartë sesa eprori që ka dhënë urdhrin, si dhe për masat e marra prej tij në zbatim të këtij neni.

5. Procedurat e dhënies, transmetimit dhe administrimit të urdhrit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 87
Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Punonjësi i policisë nuk duhet të përdorë informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.

2. Punonjësi i policisë ka detyrimin të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënavë personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënavë personale, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës. Ky detyrim zbatohet edhe nga punonjësi i policisë i liruar ose i përjashtuar.

Neni 88
Detyrimi për administrimin e pronës dhe kohën e punës

1. Punonjësi i policisë ka detyrimin të miradministrojë pronën që i vihet në përdorim në ushtrimin e detyrës dhe ta përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar nga ligji dhe Rregullorja e Policisë.

2. Punonjësi i policisë ka detyrimin të shfrytëzojë kohën e punës dhe shërbimit me efektshmëri dhe vetëm për kryerjen e detyrave.

Neni 89
Detyrime të tjera

Punonjësi i policisë në ushtrimin e kompetencave ka dhe këto detyrime:

a) të respektojë dinjitetin dhe integritetin e çdo punonjësi tjeter të policisë, përfshirë edhe vartësit e tij,

b) të marrë masat për të parandaluar arratisjen e një personi në rastet e shoqërimit, të

arrestimit dhe të zbatimit të urdhrit të ndalimit e masave shtrënguese;

c) të kërkojë ndihmë mjekësore dhe të marrë masat realisht të zbatueshme për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personit që ka në ruajtje ose që e ka dëmtuar atë gjatë kryerjes së një veprimi kur është në detyrë;

ç) t'i vijë në ndihmë një punonjësi tjetër të policisë gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ai/ajo ka nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet. Në rastet kur punonjësi i policisë që ofron ndihmën e tij është në shërbim, ai është i detyruar të vlerësojë dhe të zbatojë përparësinë në kryerjen e detyrës;

d) të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e policisë vetëm gjatë kryerjes së shërbimit dhe në përputhje me rregullat e vendosura;

dh) t'i raportojë eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit çdo ankesë të marrë në lidhje me sjelljen e një punonjësi tjetër të policisë dhe çdo shkelje, për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga ai, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera;

e) t'i raportojë eprorit përkatës ose, në mungesë të tij, eprorit të eprorit çdo shkelje, për të cilën ai ka dyshime të mjaftueshme të besojë se është kryer nga një person, pavarësisht nëse ai ka marrë dijeni për këtë shkelje gjatë kryerjes së detyrës ose në rrethana të tjera.

Neni 90

Kufizimet në jetën politike të punonjësit të policisë

Punonjësit të policisë i ndalohet:

a) të jetë anëtar i një partie ose organizate politike;

b) të mbështetë fushatën e një partie, organizate politike, të një anëtarë partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.

Neni 91

Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i policisë nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari tjetër private me përjashtim të mësimdhënieve.

2. Në rastet e mësimdhënieve, punonjësi i policisë ka detyrimin të marrë miratimin me shkrim të drejtiesit të strukturës.

Neni 92

Konflikti i interesit

1. Punonjësi i policisë ka detyrimin të shhangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës sipas legjislacionit përkatës.

2. Punonjësi i policisë ka detyrimin të informojë menjëherë eprorin e tij në rast dyshimi për një konflikt interesit dhe të zbatojë urdhrat e eprorit.

Neni 93

Rregullat për detyrimet dhe kufizimet

Rregullat për zbatimin e detyrimeve dhe kufizimeve përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit sipas kontratës kolektive të punës.

KREU XII
DISIPLINA

Neni 94
Sjellja dhe etika

Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave. Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 95
Shkeljet e disiplinës

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që bie në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

2. Shkeljet disiplinore kategorizohen në shkelje disiplinore të lehta dhe shkelje disiplinore të rënda.

3. Punonjësi i policisë, ndaj të cilit merret masë për shkelje të lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që i ka dhënë masën, brenda 5 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

4. Punonjësi i policisë, ndaj të cilit merret masë për shkelje të rëndë disiplinore, ka të drejtë të ankohet në komisionin e apelimit, brenda 10 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.

5. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të policisë duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

6. Punonjësi i policisë ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të këtij neni, në gjykatën administrative të shkallës së parë, në përputhje me legjisacionin në fuqi.

Neni 96
Masat disiplinore

(ndryshuar shkronja "a" dhe "b" të pikës 2 me ligjin nr. 112/2018, datë 20.12.2018)

1. Punonjësi i policisë që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet disiplinarisht:

a) Për shkelje të lehta disiplinore me masat:

i) vërejtje;

ii) vërejtje me paralajmërim.

b) Për shkelje të rënda disiplinore me masat:

i) shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet;

ii) ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj;

iii) përjashtim nga policia.

2. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

a) 6 muaj nga njoftimi i masës "vërejtje" dhe "vërejtje me paralajmërim";

b) një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore "shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet".

3. Llojet e shkeljeve disiplinore, procedura e shqyrtimit, ndëshkimit, ankimit për masën e dhënë, si dhe shuarja apo parashkrimi i shkeljeve e masave disiplinore për punonjësin e policisë përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

4. Efektet e masës disiplinore për punonjësin e policisë fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të ankimit.

5. Nëpunësi civil për shkeljet e kryera ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në legjislacionin për nëpunësin civil.

6. Punonjësi administrativ për shkeljet e kryera ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën individuale ose kolektive të punës.

KREU XIII SIMBOLET, UNIFORMA, PAJISJET DHE MJETET

Neni 97

Simbolet

Policia ka flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 98

Uniforma dhe shenjat e policisë

1. Punonjësi i policisë i kryen detyrat për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike me uniformën dhe shenjat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Uniforma dhe shenjat dalluese të policisë përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij. Struktura të veçanta të policisë trajtohen me veshje civile ose kompensim financiar.

2. Punonjësi i policisë pajiset me dokumentin dhe medaljonin zyrtar të identitetit, të cilat i paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës. Forma, përmasat dhe të dhënat që përmban dokumenti identifikues dhe medaljoni zyrtar i identitetit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

3. Mbajtja dhe përdorimi i uniformës përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

Neni 99

Armët dhe pajisjet

1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësit të policisë i jepen në përdorim mjetet dhe pajisjet e tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, të këtij nenit, të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

Neni 100

Mjetet e Policisë

Në ushtrimin e detyrës, policia përdor mjetet lëvizëse, ngjyra, shenja, përdorimi i të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XIV MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Neni 101

Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike

1. Kur sjellja e personit cenon rendin dhe sigurinë publike, punonjësi i policisë, në zbatim të përgjegjësive të tij dhe në përputhje me ligjin:

a) merr masa për shënjat e rrezikut për shtetasin dhe veten;

b) vlerëson nëse është e nevojshme marrja e masave shtesë ose dhënia e ndihmës dhe njofton menjëherë autoritetet përgjegjëse administrative.

2. Nëse cenimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, punonjësi i policisë merr masa për të ndërprerë veprimet e paligjshme dhe njofton prindin ose kujdestarin e të miturit.

3. Në rastet kur fëmija nuk ka prind apo kujdestar, punonjësi i policisë vë në dijeni Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve.

Neni 102

Proporcionaliteti dhe ndërprerja e masave

1. Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cenohem, si dhe nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur.

2. Masa mbetet e përshtatshme edhe nëse e ul rrezikun ose e pakëson atë përkohësisht. Nëse masa është e paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër proporcionale me ndikim më të madh.

3. Zbatimi i mëtejshëm i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet menjëherë kur shkaku i saj nuk ekziston më.

Neni 103

Zbatimi masës së menjëhershme

1. Zbatimi i masës së menjëhershme merret vetëm nëse duhet mënjanuar një rrezik real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike, i cili nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera.

2. Personi ndaj të cilit ndërmarrët masa njoftohet menjëherë.

Neni 104

Përgjegjësia për gjendjen e objekteve

Kur rendi dhe siguria publike rrezikohen ose cenohen nga gjendja e një objekti, punonjësi i policisë merr masa ndaj pronarit të objektit ose, në rast pamundësie, njofton organin kompetent. Masa mund të jepet edhe ndaj personit që sillet si pronar i objektit.

Neni 105

Masat ndaj palëve të treta dhe e drejta e kompensimit

1. Masat mund të merren edhe ndaj personave që nuk përfshihen në nenet 101 dhe 104, të këtij ligji, në qoftë se rreziku real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike ose cenimi i tyre nuk mund të shmangen ndryshe dhe për sa kohë që punonjësi përkatës i policisë nuk ka personelin dhe mjetet e duhura.

2. Sipas rrethanave të përcaktuara në pikën 1, të këtij nenit, punonjësi i policisë mund të kërkojë ndihmë. Ai gjithashtu mund të marrë përkohësisht në posedim objekte të tillë, si mjedise akomodimi, medikamente dhe ushqim, mjete pune, materiale ndërtimi dhe mjete transporti.

3. Në çdo rast të bashkëpunimit vullnetar apo të përdorimit me forcë të pronës së palëve të treta nga punonjësi i policisë që kryen veprimin lëshohet procesverbali përkatës.

4. Në çdo rast të bashkëpunimit vullnetar të një personi apo pale të tretë për ndihmë për përdorim të mjediseve, mjeteve, objekteve, sendeve të konsumit të mallrave dhe materialeve të tyre bëhet kompensimi fizik ose monetar i tyre nga organi, efektiv i të cilit është punonjësi i policisë që mori masën.

5. Lloji dhe masa e kompensimit përcaktohen duke mbajtur parasysh përgjegjësinë e

palëve dhe përfitimin nga shërbimi i ofruar, në përputhje me legjislacionin për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore dhe Kodin Civil.

6. Kur subjekti i cenuar nuk bie dakord me llojin dhe masën e kompensimit ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

Neni 106
Shpërblimi i personit për ndihmën e dhënë

1. Çdo person mund të ndihmojë policinë për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligj.

2. Nëse gjatë ndihmës që i jep policisë, personi plagoset, sëmuret apo humbet aftësitë e tij për punë, ai ka të drejtë të përfitojë çdo ndihmë mjekësore, pension, pagesë për aftësi në punë dhe pagesë në rast vdekjeje, përfitime të cilat i takojnë një punonjësi policie në rast aksidenti në punë. Paga, mbi të cilën llogariten përfitimet e mësipërme, është ajo që përfitonte personi në vendin e tij të punës ose paga për të cilën është siguruar në mënyrë vullnetare apo si privat, deri në 30 ditë para ndodhjes së ngjarjes. Ajo nuk mund të jetë më e vogël se paga bazë për gradën “Nënkomisar”. Për rastet kur personi nuk është në marrëdhënie pune ose i siguruar, paga, mbi të cilën llogariten këto përfitime, është paga bazë për gradën “Inspektor”.

Neni 107
Masa administrative

Kur punonjësi i policisë konstaton shkelje administrative, për të cilat ligji ngarkon me detyra policinë, merr masa administrative, sipas legjislacionit për kundërvajtjet administrative.

Neni 108
Njoftimi për paraqitje në polici

1. Punonjësi i policisë njofton personin për t'u paraqitur në ambientet e policisë në këto raste:

- a) për të marrë informacion për parandalimin e veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm;
- b) për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo incidentin;
- c) për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletëthirrjes, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, të dhëna për punonjësin e policisë, kohën, vendin dhe informacion për ta kontaktuar punonjësin e policisë në rast pamundësie për t'u paraqitur.

3. Kur për shkak të kushteve personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në mjeshtësi e policisë, punonjësi i policisë mund ta marrë këtë informacion në vendndodhjen e personit të njoftuar.

4. Në rastet kur personi i njoftuar nuk paraqitet në ambientet e policisë pa shkaqe dhe arsyë të përligjura, policia kryen shoqërimin kundër vullnetit të tij, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

5. Punonjësi i policisë dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera sipas pikës 1, të këtij nenit. Procesverbali, nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i paraqitur në ambientet e policisë. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit që është paraqitur në polici.

Neni 109
Shoqërimi në polici

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:
 - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
 - b) për moszbatim të urdhavrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;
 - c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepër penale;
 - ç) për të parandaluar kryerjen e një vepre penale;
 - d) kur është larguar pas kryerjes së një vepre penale;
 - dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;
 - e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;
 - ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqerinë;
 - f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.
2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.
3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.
4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjenealitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënrat e komunikuara nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.
5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Prosesverbalni nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.
6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënrat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.
7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislativit në fuqi.
8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 110
Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i policisë bën kontrollin e identitetit të personit kur:
 - a) është i pranishëm ose në afërsi të drejtpërdrejtë me vendngjarjen dhe për persona që kanë dijeni për rrethana të ngjarjes;
 - b) ndaj tij ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;
 - c) është i dyshuar për cenim të rendit dhe sigurisë publike;

ç) hyn ose del nga territori i Republikës së Shqipërisë;

d) për rrethana të kohës dhe vendit, dyshohet se është përfshirë në veprime të jashtëligjshme.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i policisë bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.

Neni 111

Arrestimi dhe ndalimi

Punonjësi i policisë bën arrestimin dhe ndalimin e personit, sipas përcaktimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 112

Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit

(shtuar shkronja "c" e pikës 2 me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime:

1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për:

- a) gjenealitet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) arsyet e shoqërimit;
- dh) orën, datën dhe vandin e shoqërimit;
- e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi;
- ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.

2. Në rast arrestimi apo ndalimi, policia evidenton për çdo person të dhënat për:

- a) gjenealitet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) veprën penale për të cilën është arrestuar apo ndaluar;
- dh) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar, të cilat merren në prani të mbrojtësit në rast se personi nuk e refuzon atë;
- e) orën, datën dhe vandin e arrestimit apo të ndalimit;
- ë) zyrën e policisë ku është mbajtur;
- f) punonjësin e policisë, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

3. Nga çdo person i arrestuar apo i ndaluar, në çdo rast, policia merr të dhënat e mëposhtme:

- a) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
- b) dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- c) mostra për nxjerrjen e profilit të ADN-së.

4. Punonjësi i policisë me gradë "Nënkomisar" apo më lart ose në rast emergjence dhe në mungesë të një punonjësi të tillë të policisë, punonjësi me gradën më të lartë mund të autorizojë përdorimin e forcës, sipas këtij ligji, për të realizuar kërkesat e pikës 3, të këtij neni, nëse personi i arrestuar apo i ndaluar kundërshton kërkesën.

5. Për personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia krijon bankën qendrore për regjistrimin e të dhënavë të mbledhura.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron dhe kontrollon fshirjen e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, të cilat i merren personit të arrestuar apo të ndaluar, mbi bazën e kërkesës së tij, nëse çështja penale në ngarkim të tij pushohet apo ai shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

7. Afati i ruajtjes së të dhënave të mbledhura në zbatim të këtij neni përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 113
Kontrolli i personit

1. Punonjësi i policisë mund të kontrollojë çdo person të arrestuar ose të ndaluar, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi:

- a) për të shmangur një rrezik real dhe të çastit;
- b) për objekte ose sende që mund të rrezikojnë jetën e tij ose të tjerëve;
- c) për të siguruar prova për kryerjen e veprës penale.

2. Kontrolli kryhet gjithmonë duke respektuar dinjitetin dhe integritetin fizik e moral të personit në një nga format si vijon:

a) kontrolli në publik i rrobave të trupit të një personi, i cili kufizohet në një kontroll sipërfaqësor të veshjeve të jashtme;

b) kontrolli i imët kryhet në vende të caktuara që nuk shihen nga publiku, ku personi i ndaluar ose i arrestuar nuk shihet nga persona të tjerë, përfshin heqjen e më shumë se veshjeve të jashtme;

c) kontrolli intim, i cili ka të bëjë me këqyrjen fizike të pjesëve të hapura në trupin e personit dhe kryhet nga punonjës të shëndetësisë vetëm në spitale ose në mjedise të tjera shëndetësore.

3. Kontrollet, sipas pikës 2, të këtij neni, kryhen nga punonjës policie të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar. Për kontrollin e të miturve kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit.

4. Kontrolli i imët mund të kryhet vetëm nëse ai vlerësohet i nevojshëm për të hequr sendin e ndaluar dhe punonjësi i policisë gjykon që personi i arrestuar apo i ndaluar mund ta ketë fshehur atë.

5. Kontrolli intim kryhet me vendim të gjykatës. Kontrolli intim ndërmerret si masë e fundit ndaj personit që dyshohet se fsheh prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale. Kontrolli intim kryhet vetëm nga një mjek ose infermier i kualifikuar.

6. Rregullat e hollësishme për kryerjen e kontrollit përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 114
Kontrolli mjekësor i personit

1. Me vendim gjykate, për të parandaluar kërcënimin për jetën, personit mund t'i bëhet kontroll mjekësor, t'i merren kampione të gjakut ose të kryhen ndërhyrje të tjera në trup nga një mjek. Kontrolli mjekësor i personit kryhet në përputhje me rregullat mjekësore për qëllime ekzaminimi, lejohet pa miratimin e personit, nëse kjo nuk dëmon ton shëndetin e tij dhe masa vlerësohet e nevojshme nga mjeku.

2. Në raste të kërcënimit të menjëhershëm, punonjësi i policisë, me nismën e tij, dërgon personin në institucionin përkatës mjekësor.

3. Të dhënat e mbledhura gjatë kontrollit përdoren vetëm për qëllimin e këtij neni.

Neni 115

Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve

1. Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t'u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore.

2. Personi, i cili shoqërohet nga policia sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës në çdo kohë.

3. Punonjësi i policisë, pasi e ka regjistruar kërkesën/ankesën, e dokumenton në regjistrin përkatës dhe është i detyruar ta dërgojë menjëherë atë në institucionin të cilit i adresohet ankesa.

4. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluari apo i arrestuari, përgjigja i jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre.

Neni 116

Kontrolli i objekteve dhe automjeteve

1. Një objekt, me përjashtim të mjediseve të përcaktuara në nenin 118, të këtij ligji, kontrollohet nëse:

a) zotërohet nga personi që është kontrolluar sipas nenit 119, të këtij ligji;

b) faktet bëjnë të dyshohet se brenda objektit ndodhet personi:

i) që duhet të arrestohet ose të ndalohet;

ii) që është mbajtur në mënyrë të jashtëligjshme;

iii) për të cilin punonjësi i policisë ka dyshime të bazuara se kontrolli është i nevojshëm për mbrojtjen e jetës nga një rrezik i çastit;

c) faktet bëjnë të dyshohet se aty ndodhet një send që mund të sekuestrohet.

2. Kontrollohet automjeti në të cilin ndodhet personi, identiteti i të cilit mund të verifikohet në një pikë kontrolli. Kur ekziston një nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kontrolli bëhet edhe ndaj sendeve brenda automjetit.

3. Përdoruesi i objektit dhe/ose i mjetit ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. Nëse ai nuk paraqitet, ftohet një përfaqësues apo dëshmitar tjetër. Përdoruesit duhet t'i dorëzohet një kopje e procesverbalit të kontrollit dhe arsyet, nëse kërkohen prej tij.

Neni 117

Ndërhyrja në mjedise

1. Mjedise, në kuptim të këtij neni, janë banesat dhe dhomat ngjitur me to, zyrat e punës, garazhet, magazinat, kapanonet, bodrumet, mjediset e veprimtarisë profesionale, tregtare, blegtore, bujqësore, si dhe çdo pronë tjetër privatë që lidhet me to.

2. Ndërhyrja dhe kontrolli në mjedise mund të bëhen pa lejen e pronarit nëse:

a) është e nevojshme të parandalohet një kërcenim i çastit për jetën dhe shëndetin;

b) në çdo rast të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

3. Nëse pronari apo personi që zotëron mjedisin ose përfaqësuesi i tij nuk janë të pranishëm gjatë ndërhyrjes, sipas pikës 1, të këtij neni, duhen njoftuar menjëherë për arsyen e kontrollit për sa kohë që qëllimi i masës së marrë nuk vihet në rrezik.

4. Në të gjitha rastet e hyrjes dhe të kontrollit, sipas këtij neni, punonjësi i policisë harton një procesverbal në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, ku ndër të tjera përmenden arsyet e hyrjes, kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij. Një kopje e këtij raporti i jepet, sipas kërkesës, personit të interesuar ose personave të autorizuar prej tij.

Neni 118
Kontrolli kundër akteve terroriste

1. Punonjësi i policisë, kur ka dyshime të arsyeshme ka të drejtë të kryejë me iniciativë kontolle për parandalimin e akteve terroriste në banesa, ndërtesa, mjedise dhe hapësira publike për të garantuar sigurinë e personave dhe të rendit kushtetues kombëtar e sigurinë ndërkombe të.

2. Kontrolli kundër akteve terroriste përfshin kontrollin për eksplozivë, lëndë helmuese kimike, biologjike, bakteriologjike apo radioaktive.

3. Këtë të drejtë e ushtron në rastet e flagrancës, në rast ndjekjeje të personit, si dhe kur ka prova apo informacione të besueshme se është duke u përgatitur një akt terrorist dhe kur nga vonesa e ushtrimit të kontrollit mund të zhduken ose të humbasin mjetet ose gjurmët e kryerjes së krimtit.

4. Pas ushtrimit të kontrollit, punonjësi i policisë har ton procesverbalin përkatës dhe ia dërgon brenda 48 orëve prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli. Një kopje e procesverbalit i lihet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar.

5. Personi i kontrolluar nga policia ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente ku ndodhet struktura poliore, nëse e konsideron kontrollin si të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Neni 119
Largimi nga vendndodhja

Për të shmangur kërcënimin për rendin ose sigurinë në mjedise publike, punonjësi i policisë mund të urdhërojë personin të largohet nga vendndodhja ose mund ta ndalojë atë të hyjë në mjedise, për aq kohë sa ky kërcënim vazhdon.

Neni 120
Bllokimi i rrugëve

Për nevoja të rendit e sigurisë publike dhe të zbatimit të ligjit ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, punonjësi i policisë blokon pjesë të rrugëve ose të mjediseve publike deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

Neni 121
Bllokimi dhe sekuestrimi i sendeve

1. Sendet bllokohen ose sekuestrohen vetëm në rastet kur lejohet me ligj dhe në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike. Punonjësi i policisë, që vepron, har ton procesverbalin përkatës, i cili i jepet poseduesit nëse ai nijhet.

3. Sendet bllokohen për një periudhë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 30 ditë. Pas kësaj, sendet i kthehen poseduesit nëse është identifikuar ose nëse identifikohet pa vonesë. Nëse brenda 90 ditëve nga bllokimi, siç mund ta kërkojë natyra e sendit, poseduesi i sendit nuk mund të identifikohet ose nuk kërkon me dëshirën e tij kthimin e sendit, sendi i bllokuar kalon në favor të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Policia ka përgjegjësinë të kryejë verifikime për identifikimin e pronarit të sendeve të bllokuara.

Neni 122
Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitime të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

2. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsy mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të tjerëve.

3. Mbajtja e personit në ambientet e policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë.

4. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1, të këtij nenit, punonjësi i policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave, në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

5. Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Prosesverbal i nënshkruhet në fund të çdo fletë nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.

Neni 123
Masat mbrojtëse ndaj të miturve

1. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e të miturit të braktisur nga prindi ose që është larguar nga prindi a kujdestari i tij.

2. Punonjësi i policisë i referon rastin njësinë e mbrojtjes së fëmijës për një vlerësim të rastit të të miturit.

3. I mituri i rikthehet prindit, kujdestarit, pasi vlerësohet më parë mospërfshirja e tyre në abuzimin ndaj të miturit.

4. I mituri dërgohet në qendrat e përkujdesjes për të miturit kur vlerësohet se është i abuzuar ose i braktisur nga prindi ose kujdestari i tij.

5. I mituri mbahet në ambientet e policisë për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë. Kushtet e mbajtjes së të miturit duhet të mbajnë parasysh nevojat të moshës dhe psikologjike.

6. Punonjësi i policisë bashkëpunon me qendrat e përkujdesjes sociale për të miturit për ofrimin e asistencës së nevojshme ndaj të miturit.

Neni 124
Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale nga policia kufizohet vetëm me ato të dhëna që janë të nevojshme për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit e sigurisë publike, si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen dhe hetimin e veprave penale.

2. Për të realizuar mbledhjen e të dhënave, policia mund të përdorë edhe bashkëpunimin e fshehtë me individë, regjistrimin me kamera në mjedise publike, vëzhgimin në mënyrë të fshehte

të personave dhe mjetave, si dhe pajisjet gjurmuese të vendndodhjes, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

3. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime policore ruhen në dosje përkatëse, të ndara nga dosjet administrative, të cilat u nënshtronen dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime policore përdoren vetëm për atë qëllim, pa cenuar dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Të dhënat e ruajtura për qëllime policore evidentohen me një shenjë që tregon besueshmérinë dhe saktësinë e tyre. Për këtë qëllim, miratohet dhe zbatohet një sistem kodimi.

6. Ndalohet mbledhja e të dhënave të subjekteve të të dhënave vetëm për shkak se i përkasin një origjine ose etnie të caktuar, bindjeje të veçantë fetare, orientimi seksual ose bindjeje politike apo i përkasin një lëvizjeje ose organizate, e cila nuk parashikohet me ligj.

7. Organet e administratës publike, personat fizikë dhe juridikë, janë të detyruar t'i paraqesin të dhënat identifikuese dhe informacionet e mbledhura në mënyrë të ligjshme, kur u kërkohet nga policia, përjashtuar të dhënat, shpërndarja e të cilave është e ndaluar me ligj.

8. Gjatë përbushjes së funksioneve të saj, policia respekton të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, deri në masën që nuk cenohen përgjegjësitë e saj.

9. Çdo person ka të drejtë të ankohet në rast se vlerëson se policia ka shkelur të drejtat e tij/saj për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Të dhënat personale fshihen apo bëhen anונית, kur nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur. Nevoja e vazhdimit të ruajtjes së çdo grupei të caktuar të dhënash personale do të vlerësohet në mënyrë periodike sipas legjislacionit përkatës.

Neni 125

Të drejtat e subjektit të të dhënave personale

1. Çdo person ka të drejtë pa pagesë të kërkojë me shkrim informacion për të dhënat personale, që përpunohen nga policia.

2. Kërkesa refuzohet në mënyrë të arsyetur në rast se ky refuzim është i nevojshëm për të bërë të mundur që policia të përbushë detyrat e saj.

3. Çdo person ka të drejtë të kërkojë nga policia korrigimin apo fshirjen e të dhënave të pasakta në lidhje me të.

4. Në çdo rast, policia i kthen përgjigje me shkrim subjektit brenda 30 ditëve pune.

5. Rregullat, procedurat e pranimit, të shqyrtimit e të kthimit të përgjigjes së kërkuesës për informacion mbi të dhënat personale përcaktohen sipas legjislacionit përkatës.

Neni 126

Komunikimi i të dhënave personale te palët e treta

1. Komunikimi i të dhënave me agjencitë e tjera ligjzbatuese lejohet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për raste të tjera, kur ekziston detyrim i qartë ligjor ose autorizimi që lejon komunikimin është i domosdoshëm për parandalimin e një rreziku serioz potencial apo kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij.

2. Të dhënat e komunikuara nuk do të përdoren për qëllime të tjera përvëç atyre për të cilat ato janë marrë. Policia jep pëlqimin për përhapjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 127
Siguria dhe konfidencialiteti

1. Policia merr masa organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, aksesi ose përhapja te persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.

2. Cdo person që ka akses në të dhënat personale të mbledhura, të ruajtura dhe të përpunuara nga policia, gjatë ushtrimit të detyrës i nënshtronhet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit edhe pas përfundimit të ushtrimit të funksioneve të tyre, përvèç kur parashikohet me ligj.

Neni 128
Transferimi ndërkontrollor i të dhënave

1. Transferimi ndërkontrollor i të dhënave bëhet duke respektuar parimet dhe rregullat, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkontrollor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Transferimi i të dhënave tek autoritetet e huaja kufizohet vetëm për organet policore dhe është i lejueshëm vetëm nëse:

a) ekziston një dispozitë ligjore në legjislacionin kombëtar dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkontrollore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;

b) në mungesë të kësaj dispozite, transferimi është i nevojshëm për parandalimin, hetimin, zbulimin e veprave penale ose për zbatimin e ndëshkimeve penale dhe shteti marrës duhet të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave personale;

c) në përjashtim nga rregulli i mësipërm, transferimi është i nevojshëm për parandalimin e një krimi.

3. Përshtatshmëria e nivelit të mbrojtjes, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij nenit, vlerësohet nga Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në bazë të rrethanave në të cilat ndodhet procesi i transferimit të të dhënave.

Neni 129
**Detyrimi i institucioneve shtetërore dhe private
për dhënie informacioni**

1. Institucionet shtetërore dhe subjektet private, që kanë apo krijojnë bazë të dhënash për identitet të shtetasve, të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të shtetasve apo subjekteve tregtare, për regjistrimin e automjeteve dhe lejeve të drejtimit, për subjektet tregtare dhe për eksportet apo importet e tyre, të identitetit të abonentëve telefonikë, identifikimin e pajisjes fundore dhe vendndodhjen etj., për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, janë të detyruar të jepin akses për njohjen dhe përpunimin e tyre nga punonjësit e policisë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep autorizimin për punonjësit e policisë për njohjen dhe përdorimin e të dhënave.

3. Punonjësi i policisë në njohjen dhe përdorimin e këtyre të dhënave respekton parimet dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 130
Bashkëpunimi i fshehtë me individë

1. Punonjësi i policisë detyrohet të pranojë dhe të vlerësojë çdo informacion që vjen nga persona dhe që lidhet me mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike dhe/ose parandalimin dhe zbulimin e veprave penale.

2. Kur një person vendos marrëdhëniet tē fshehta bashkëpunimi me polisinë pér tē informuar pér çështje që lidhen me mbrojtjen e rendit e tē sigurisë publike dhe/ose pér parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprave penale, është i detyruar tē ruajë sekretin e këtij bashkëpunimi dhe tē informacioneve tē klasifikuara, derisa tē përfundojë detyrimi ligjor pér ruajtjen e sekretit.

3. Punonjësi i policisë ka detyrimin tē ruajë fshehtësinë e identitetit dhe tē rrethanave tē tjera pér personin që bashkëpunon në mënyrë tē fshehtë me Policinë.

4. Rregullat e bashkëpunitit përcaktohen nga ministri.

Neni 131
Masa tē vecanta

1. Kur në bazë tē tē dhënavë që disponohen dyshohet se një person ka kryer një vepër penale ose po planifikon apo po organizon që tē kryejë një krim dhe kjo veprimtari nuk mund tē zbulohet ose tē parandalohet në rrugë e mënyra tē tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, punonjësi i policisë me gradën “Kryekomisar” ose më lart, sipas juridikzionit lëndor, kërkon autorizimin nga prokurori pér tē marrë masat e mëposhtme:

a) përgjimin e fshehtë ambiental dhe procedural tē bisedave tē personave në vende publike ose në mjete transporti;

b) përgjimin e fshehtë tē bisedave telefonike ose telekomunikimeve tē personave, në përputhje me legjislacionin përkatës;

c) përdorimin e pajisjeve teknike pér fotografim, regjistrim audio ose video, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Përdorimi i masave tē vecanta, sipas pikës 1, tē këtij nenit, lejohet pér aq kohë sa ekzistojnë arsyet ose rrethanat që kanë bërë tē nevojshëm autorizimin e tyre pér përdorim vecmas ose tē kombinuar dhe zgjat sipas afateve tē vendosura në legjislacionin përkatës.

3. Kur referimi i veprës penale, pér tē cilën janë përdorur masat e vecanta, nuk bëhet brenda gjashtë muajve pas përfundimit tē përdorimit tē masave tē vecanta, tē parashikuara në këtë nen, i gjithë informacioni i mbledhur si rezultat i përdorimit tē këtyre masave asgjësohet, sipas rregullave tē përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

4. Kur në vende tē vecanta kryhen në mënyrë tē përsëritur përgjime ambientale procedurale, me autorizim tē Prokurorit tē Përgjithshëm dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, strukturat e policisë ndërtojnë impiante stacionare tē përgjimit ambiental.

5. Rregullat teknike pér realizimin e vendimit tē përgjimit ambiental procedural dhe parandalues, si dhe pér ndërtimin dhe shfrytëzimin e impianteve stacionare tē përgjimit ambiental përcaktohen me udhëzim tē përbashkët tē ministrit dhe Prokurorit tē Përgjithshëm.

Neni 132
Përpunimi i informacionit policor

1. Përpunimi i informacionit policor është procesi i grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit tē informacionit pér nevoja tē mbrojtjes së rendit e tē sigurisë publike ose pér nevoja tē parandalimit e zbulimit tē veprave penale.

2. Përpunimi i informacionit policor bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Rregullat konkrete për realizimin e përpunimit të informacionit policor prej strukturave përkatëse, si dhe masat për ruajtjen e të dhënavë e për kontrollin e kësaj veprimtarie informative përcaktohen nga ministri.

Neni 133
Përdorimi i forcës

1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.

2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrëthanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen.

Neni 134
Përdorimi i armëve të zjarrit

Punonjësi i policisë ka të drejtë të përdorë armën e zjarrit, sipas legjislacionit për përdorimin e armëve të zjarrit.

Neni 135
Kryerja e operacioneve speciale

1. Për kryerjen e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhjen e situatave, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e tjera të policisë, përdoren struktura speciale operacionale të policisë.

2. Përgjegjësitë e këtyre strukturave janë:

a) cilrimi i pengjeve;

b) kapja e personave të armatosur me rrezikshmëri të lartë dhe transportimi i tyre në mjeshterësi e policisë;

c) mbështetja e strukturave, të cilat sigurojnë personalitetet e larta shtetërore, të vendit ose të huaja, në rastet kur ka të dhëna për akte terroriste ndaj tyre;

ç) rivendosja e rendit dhe e sigurisë publike, kur kjo është e pamundur vetëm me strukturat e tjera policore;

d) marrja në ruajtje e personave, të cilëve u kërcënohen jeta për shkak të detyrës.

3. Punonjësve të strukturave speciale operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale.

4. Kur nga punonjësit e policisë së strukturave speciale operacionale, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, para ose pas operacionit kryhen vepra penale, ndaj tyre ndiqen procedurat ligjore

si për gjithë shtetasit e tjerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të vëré në dispozicion të organeve të drejtësisë personat dhe dokumentacion e nevojshëm, me qëllim kryerjen e hetimeve.

Prokuroria dhe gjykata të zbatojë metodat dhe format ligjore të procedimit, të cilat garantojnë sekretin e klasifikuar policor, sipas nenit 14, të ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”.

5. Funksionimi i strukturave speciale operacionale, si dhe procedurat, rregullat dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 136

Rregullorja e Policisë

Rregullorja e Policisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XV BURIMET FINANCIARE

Neni 137

Buxheti i policisë

1. Buxheti i Policisë së Shtetit është program i veçantë brenda buxhetit të ministrisë, të emërtuar “Policia e Shtetit”.

2. Drejtuesi i këtij programi është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe buxheti i këtij programi miratohet në ligjin vjetor të buxhetit.

3. Përgjegjësitet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si drejtues i programit buxhetor, si dhe të drejtuesve të njësive shpenzuese në përbërje të këtij programi për hartimin e zbatimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, ruajtjen e mbrojtjen e aktivëve në përdorim ushtrohen sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Neni 138

Fondi i veçantë

(shfuqizuar pika 2, ndryshuar referenca ligjore në pikën 4, me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Buxheti i Policisë ka një zë të veçantë për pagesën e personave për rastet e operacioneve të veçanta poliore, për informatorët, burime të tjera dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

2. Shfuqizuar.

3. Fondi i veçantë administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

4. Fondi i veçantë për mbulimin e efekteve financiare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nuk mund të jetë më pak se 1 për qind e buxhetit vjetor të polisë.

Neni 139

Donacionet

Policia e Shtetit pranon donacione. Pranimi, administrimi dhe përdorimi i tyre bëhen në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KREU XVI CERTIFIKATAT

Neni 140
Certifikata vlerësimi

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep certifikata për punonjësit e policisë, të dalluar në kryerjen e detyrave.

Neni 141
Llojet e certifikatave

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep këto certifikata:

- a) certifikatë për shërbime të dalluara.
- b) certifikatën e karrierës.

2. Motivimi, rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e certifikatave përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

KREU XVII
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 142

Trajtimi i punonjësve të policisë

(ndryshuar pika 5 dhe shfuqizuar pika 7, me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

1. Punonjësi i policisë do të ruajë të njëjtën gradë që ka edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Nëse funksionit, në të cilin është emëruar, i është caktuar një gradë më e ulët, në zbatim të nenit 61, të këtij ligji, punonjësi i policisë do të mbajë këtë gradë më të lartë dhe do të trajtohet financiarisht, sipas kësaj grade, për një periudhë deri në 1 vit.

2. Gjatë periudhës 1-vjeçare, funksioni i lirë që i korrespondon gradës që mban punonjësi nuk shpallet funksion i lirë për konkurrim dhe në këtë funksion emërohet punonjësi që ka gradë më të lartë se funksioni për shkak të zbatimit të këtij ligji.

3. Në përfundim të periudhës 1-vjeçare, nëse punonjësi i policisë nuk është i emëruar në funksion në përputhje me gradën që mban, ai merr gradën korresponduese të funksionit. Nëse punonjësi nuk pranon të mbajë gradën korresponduese të funksionit, ai lirohet nga policia.

4. Punonjësve të policisë që kanë gradën “Nëninspektor” dhe “Kryeinspektor”, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do t’u jepet grada policore “Inspektor”. Afati i qëndrimit në gradë për punonjësit me gradë “Kryeinspektor”, përfundimtari i këtij gradës “Nënkomisar”, fillon nga momenti që punonjësi ka marrë gradën “Kryeinspektor”.

5. Punonjësi që është në periudhë prove, pavarësisht nga marrja e gradës “Inspektor”, periudha 1-vjeçare e provës i fillon nga momenti që ka përfunduar arsimin policor.

6. Punonjësi i policisë, që ka ndërprerë marrëdhëni e punës për t’u punësuar në strukturat operacionale me gradë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është në marrëdhënie pune në këto struktura në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka të drejtë të rikthehet në polici me të njëjtën gradë brenda një periudhe 3-vjeçare nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

7. Shfuqizuar.

8. Për Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ndryshohet emërtimi i funksionit të tyre sipas përcaktimeve të këtij neni dhe vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë vetëm nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë ligj, deri në përfundim të mandatit të parashikuar në kohën e emërimit të tyre sipas ligjit të kohës.” .

Neni 143
Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 19, pika 6; 37, pika 5; 38 pika 3, 61 pika 1; 62, 63 pika 6, 64 pika 3, 67 pika 2; 68, pika 4; 69, pika 3; 70 pika 2, 71, 72 pika 2; 75 pika 1, shkronja “ç”, dhe pika 2; 81, pika 2; 97, 98 pika 1; 100; 136.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 19 pika 7; 27, pika 4, dhe 130, pika 4.

3. Ngarkohet ministri që, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, të nxjerrë udhëzimin e përbashkët, të parashikuar në nenin 131, pika 5.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare.

Dispozitë kalimtare
(shtuar me ligjin nr. 58/2017, datë 20.4.2017)

Afati i qëndrimit në detyrë për drejtorin e departamentit fillon pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 144
Shfuqizimi i akteve

Ligi nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, ligi nr. 31/2014, “Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit”, si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 145
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 31.7.2014